



This project is financed
by the European Union



BASHKË KUNDËR

EKSTREMIZMIT, TERRORIZMIT
DHE RADIKALIZMIT TË DHUNSHËM

2018

"Kjo broshurë u realizua në kuadër të projektit "Shoqëria civile kundër ekstremizmit të dhunshëm", financuar nga Bashkimi Evropian. Përbajtja e saj është përgjegjësi e plotë e Komitetit Shqiptar të Helsinkit dhe nuk reflekton domosdoshmërisht qëndrimin zyrtar të Bashkimit Evropian."

BASHKË KUNDËR EKSTREMIZMIT, TERRORIZMIT DHE RADIKALIZMIT TË DHUNSHËM

Përgatiti broshurën:

Znj. Arta Mandro - eksperte Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Redaktoi:

Hysni Ndreu

Supervizim:

Erida Skëndaj - Drejtore Ekzekutive e KShH- së

Miriam Angoni - menaxhere program në KShH

Klejda Ngjela - menaxhere projektesh në KShH

Autor: ©Komiteti Shqiptar i Helsinkit


Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për subjektin autor.

Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet pa lejen dhe citimin e tij.

Nëse jeni të interesuar për këtë broshurë,
mund të kontaktoni me Komitetin Shqiptar të Helsinkit në adresën e mëposhtme:

Rr. Brigada e VIII-te, Pallati "Tekno Projekt"
Shk 2 Ap 10, Tirana-Albania
Kutia Postare nr.1752
Tel: +355 4 2233671 Cel: +355 682135517
<https://www.facebook.com/KomitetiShqiptariHelsinki/>
e-mail: office@ahc.org.al;
www.ahc.org.al

BASHKË KUNDËR EKSTREMIZMIT, TERRORIZMIT DHE RADIKALIZMIT TË DHUNSHËM



PËRSE DUHET TË KEMI NJOHURI MBI EKSTREMIZMIN DHE RADIKALIZMIN?

Sepse është mënyra më e mirë për t'i parandaluar ata;
sepse janë fenomene të rrezikshme dhe negative që ndodhin në ditët e sotme; sepse Shqipëria dhe shqiptarët nuk janë të imunizuar ndaj tyre.

Që të mbrohem prej tyre duhet të rrisim vigilencën, të dimë se si shfaqen dhe çfarë pasojash sjellin, por pa u mbërthyer nga paniku.



JETOJMË NË NJË BOTË PLOT NDRYSHIME E NGJASHMËRI.

Kjo është bukuria e jetës. Eksplorimi i tyre në mënyrë paqësore është pjesë e rritjes dhe nuk duhet të ngatërrohet me diçka të keqe. Vetëm duke folur hapur kuptojmë të drejtën nga e gabuara dhe të mirën nga e keqja. Siç thotë Albert Ainshtajni: **"Paqja nuk mund të mbahet me forcë; ajo mund të arrihet vetëm duke kuptuar."**

Ekstremistët e dhunshëm përdorin arsyen e ndryshme për t'i bindur njerëzit që të bashkohen me ta. Ata duan që ju të ndiheni të zemëruar ose të mërzitur për një problem të caktuar dhe të besoni se zgjidhja e vetme është dëmtimi i njerëzve të tjerë, shkatërrimi i grupeve të caktuara ose i qeverisë. Ata ju premojnë se do të jeni më të lumtur dhe më të veçantë nëse i mbështesni.



MOS U SHNDËRRO NË KUKULL!

Ekstremistët e dhunshëm do t'ju tregojnë gjenjeshtra për t'ju ndihmuar që të mbështesni kauzën e tyre. Mos u shndërrro në kukull! Vetëm për shkak se dikush duket i bindshëm, ose bën premtime të mëdha, nuk do të thotë që ju duhet t'i bashkoheni atij në dëmtimin e njerëzve të pafajshëm.

ÇFARË JANË EKSTREMIZMI DHE RADIKALIZMI?

Ekstremizmi është një formë aktive e kundërshtimit të vlerave themelore të demokracisë, të sundimit të ligjit, të lirisë individuale dhe lirisë e të drejtave themelore të njeriut, të respektit të ndërsjellë dhe tolerancës së besimeve e bindjeve të ndryshme. Ekstremizmi i dhunshëm nënkupton përdorimin e dhunës si mjet për arritjen e objektivave.

Ekstremist është dikush, opinioni i të cilit, sidomos mbi fenë apo politikën, nuk është i arsyeshëm ose i pranueshëm për shumicën e njerëzve. Ruajtja e pikëpamjeve ekstremiste nënkupton që, pavarësisht nga raca ose feja, njerëzit apo ngjarjet shihen me një qëndrim të mbyllur dhe jo tolerant.

Radikalizmi i dhunshëm është një vendimmarje që anashkalon proceset politike dhe metodat paqësore, me qëllim që të sjellë ndryshime duke nxituar e favorizuar përdorimin e metodave të dhunshme. Radikalizmi terrorist është ai proces, i cili rezulton në pranimin e dhunës terroriste si një rrugë e mundshme dhe legitime veprimi.

Radikalizimi është procesi, përmes të cilit një person mbështet terrorizmin dhe ideologjitet ekstremiste të lidhura me grupet terroriste.

Ç'LIDHJE KA NDËRMJET RADIKALIZMIT DHE EKSTREMIZMIT?

Kemi dëgjuar të thuhet për dikë se është 'radikal', sikurse kemi dëgjuar të përdoret shprehja 'politikë radikale'. Termi radikal përdoret zakonisht për ata individë, të cilët janë kundër ideve dhe opionieve të përgjithshme që mbizotërojnë në një shoqëri. **Radikalizmi, si koncept i vetëm, në rastet kur nuk shoqërohet me dhunë, nuk përbën kërcënim për shoqërinë.** 'Radikalët' dhe 'radikalizmi' synojnë të ndryshojnë strukturën ekzistuese politike dhe shoqërore, por kjo nuk është domosdoshmërisht e dhunshme.

Radikalizmi merr nuanca të ekstremizmit atëherë kur individët radikalë përdorin dhunën dhe angazhohen në aktivitete të paligjshme, duke përfshirë edhe terrorin, me qëllim arritjen e objektivave të tyre sociale, politike ose ekonomike.

Në këtë kontekst, 'ekstremizmi' i referohet miratimit të një ideologjie të veçantë, me qëllim të përdorimit të dhunës për të goditur shtetin, strukturën qeverisëse dhe drejtuesit e saj. Në rastin më të keq, një ekstremist shpreh urrejtje dhe dhunë ndaj të tjerëve. Nuk duhet të mendojmë se ekstremistët dallohen lehtë nga pamja e tyre e jashtme, nga fiziku ose nga mënyra se si vishen. Ajo çka i bën të dallueshëm dhe të ndryshëm është mënyra se si e shohin botën dhe qëndrimet e tyre për botën.

PSE NDODHIN DHE SI SHFAQEN?

Ekstremizmi krijohet aty ku grupet e ndryshme brenda një komuniteti janë të izoluar ose dyshues ndaj njëri-tjetrit. Ekstremistët e shkelin ligjin. Ata shkojnë përtej asaj që është e pranueshme, duke përfshirë:

- ▶ Përdorimin e dhunës, kërcënimeve ose intimidimeve;
- ▶ Mbajtjen e një qëndrimi të mbyllur dhe jo të hapur ndaj pikëpamjeve të tjerëve;
- ▶ Të qenët i përkushtuar vetëm ndaj një sistemi besimi, duke përashtuar çdo gjë tjetër.

Ekstremizmi mund të shfaqet nëpërmjet shumë trajtave, të tilla si: ekstremizëm ekstrem i djathë; grup racist; grupe me bindje të forta pro, ose antifetare; njerëz që diskriminojnë LGBTIQ¹; njerëzit me mënyrë jetese dhe besime që janë jashtë "normës"; madje edhe aktivistë për të drejtat e kafshëve.

SHENJAT E RADIKALIZIMIT MUND TË JENË:

- ▶ Ndryshime të humorit, zemërimi, arroganca;
- ▶ Shprehja e pikëpamjeve të reja ekstreme;
- ▶ Ndryshime në pamje;
- ▶ Një grup i ri miqsh;
- ▶ Shpenzimi i kohës së tepërt në internet.



¹ Lesbike, gei, biseksual, transgjinorë, interseksual. "Q" vjen nga Questioning dhe është akronim i përdorur për individët që nuk e kanë ende të qartë individualitetin e tyre gjinor ose seksual.

Ç'ËSHTË TERRORIZMI?

Terrorizmi është përdorimi i paligjshëm i dhunës, ose kërcënimi me dhunë për të mbështetur një besim apo ideologji. Terrorizmi është një kërcënim ndaj paqes dhe sigurisë.

ÇFARË NGYRIMESH MERR EKSTREMIZMI I DHUNSHËM NË SHQIPËRI?

Në Shqipëri ekstremizmi i dhunshëm lidhet me përdorimin e fesë dhe të ideologjisë fetare për të përligjur veprime të dhunshme.


CILËT FAKTORË I NXISIN KËTO FENOMENE?

PO NË KONTEKSTIN SHQIPTAR?

Edhe në Shqipëri radikalizmi terrorist dhe rekrutimi e kanë një bazë. Ka një proces interaktiv bashkëpunimi midis individit dhe influencave të jashtme. Në Shqipëri, shfaqja e fenomenit është kryesisht e lidhur me faktorët socio-ekonomikë. Pothuajse të gjithë individët që janë bashkuar me konfliktin, vijnë nga disa prej zonave më të varfra të vendit dhe jetojnë pothuajse në veçim të plotë nga shoqëria në tërsësi.

Varfëria ekstreme dhe mungesa e rolit të duhur të strukturave shtetërore çojnë në mungesën e zhvillimit të këtyre zonave. Kjo nxit edhe një mungesë të përgjithshme të perspektivës për jetën e këtyre individëve. Organizatat ekstremiste dhe fondacionet islame të pakontrolluara nga strukturat zyrtare të komunitetit mysliman apo nga strukturat shtetërore përkatëse, janë përpjekur vazhdimisht që të futin një perspektivë dhe qëllim të ri në jetën e këtyre individëve të dëshpëruar dhe të harruar.

Sa i përket perceptimit të publikut për shkaqet që ndikojnë në rritjen e këtij fenomeni, sondazhi i kryer nga Instituti Shqiptar i Studimeve Ndërkombëtare (ISHN) evidenton se 41.3% e pjesëmarrësve fajësojnë varférinë ekstreme, 21.1% e lidhin me arsyen financiare, rreth 10% tregojnë për nivelet e ulëta të arsimit, ndërsa 12.6% fajësojnë vetë ideologjinë islame radikale.



ÇFARË E FAVORIZON DHE MBËSHTET PËRHAPJEN E KËTYRE FENOMENEVE?

Të gjithë duam të jemi të lumtur dhe të bëjmë ndryshime në jetë, por përmbushja e këtyre nevojave përmes aktiviteteve të dhunshme nuk është përgjigjja e duhur. Asnjë arsy nuk e justifikon faktin që njerëzit të bëhen ekstremistë të dhunshëm, megjithatë, ndodh shpesh që dikush përpinqet të plotësojë një nevojë të thellë personale. Për shembull, një person mund të ndihet i vetëm ose sikur jeta e tij nuk ka kuptim. Individët që preken emocionalisht pas një ngjarjeje stresuese, mund të janë vulnerabël edhe ndaj rekrutimit. Më anë tjetër, disa njerëz bëhen ekstremistë të dhunshëm për shkak se nuk pajtohen me politikat e qeverisë, urrejnë njerëz të caktuar, nuk ndihen të vlerësuar nga shoqëria, ose mendojnë se kanë mundësi të kufizuara për sukses.

Një sërë kushtesh që favorizojnë kultivimin e këtyre fenomeneve janë të natyrës strukturore, sociale, ekonomike dhe politike, të tilla si: diskriminimi dhe forma të tjera të shkeljes së të drejtave të njeriut, mungesa e aksesit në arsim, përjashtimi nga përfaqësimi politik, marginalizimi shoqëror dhe ekonomik, keqverisja.

KUJDES!

Nevojat personale të paplotësuara, të tilla si zotërimi i fuqisë dhe pushtetit, të ndjerit i rëndësishëm dhe superior, eksitimi etj., mund ta çojnë një individ në ekstremizëm të dhunshëm.

- » Ata që duan të bëjnë ndryshime pozitive në jetë, mund të mendojnë gabimisht se kjo gjë arrihet duke marrë pjesë në sulme të dhunshme, ose të nxitur nga urrejtja.
- » Ata që kërkojnë miq të rinj, mund të besojnë gabimisht te grupet ekstremiste të dhunshme.
- » Ata që kërkojnë njohje dhe vëmendje mund të kthehen në ekstremistë të dhunshëm, edhe nëse kjo do të thotë të dëmtojnë njerëzit e tjerë.
- » Ata që kërkojnë një qëllim në jetë mund të tërhiqen nga ideologjitet e shtrembëruara të ekstremizmit të dhunshëm.
- » Ata që kanë frikë nga pikëpamje të ndryshme dhe nga mënyra e jetesës, mund të tërhiqen nga ekstremizmi i dhunshëm ose nga grupet e urrejtjes.
- » Ekstremizmi i dhunshëm mund të ofrojë një premtim të rremë eksitues dhe të magjishëm për ata që janë të mërzitur me jetën që bëjnë.

CILAT JANË ZONAT MË PROBLEMATIKE NË SHQIPËRI?

Nga një perspektivë gjeografike, rritja e këtij fenomeni është e përqendruar në qytetet e Elbasanit, Pogradecit, Librazhdit, Bulqizës, Cërrikut, Kukësit, Dibrës, kryesisht në zonat rurale që rrrethojnë këto qytete. Përveç kësaj, ky fenomen është i pranishëm edhe në periferi të Tiranës dhe të Durrësit. Me fjalë të tjera, ka hedhur rrënjet aty ku shifrat e larta të papunësisë dhe nivelet e ulëta të arsimimit, deri në mosnjohjen e shkrimit a të leximit, janë shqetësuese, pra, në zonat rurale.

A KA NJË KATEGORI OSE GRUPMOSHË QË GJENDET MË NË RREZIK PËR SHKAK TË NDIKIMEVE NGA INDOKTRINIMI DHE PËRQAFIMI I KËTYRE AKTEVE TË PALIGJSHME?

Përgjithësisht nuk ka një moshë, gjini, fe, etni ose sfond tipik, që e shtyn dikë të bëhet terrorist.


Ata janë shpesh persona vulnerabël, të shënjestruar nga një grup ekstremist. Këto grupe i japin atij personi një ndjenjë përkatësie, një ndjenjë të statusit dhe nganjëherë një premtim shpërblimi.

Në Shqipëri, grupmosha më e ndjeshme ndaj indoktrinimit është ajo e moshës 17-35-vjeçare. Në periudhën 2010-2015, 8-21% e fuqisë punëtore në Shqipëri ishte e papunë. Niveli i papunësisë në grüpин e 17-35-vjeçarëve shkon nga 40 në 45%.

8-21%

PAPUNËSIA
MOSHA 17 - 35 VJEÇARE
2010 - 2015

40-45%



Ç'MËNYRA PËRDOREN PËR TË LEGJITIMUAR DHE RRITUR TËRHEQJEN KUNDREJT KËTYRE AKTEVE?

- » Përdorimi i logjikës se arsyea justifikon mjetin;
- » Zhveshja e viktimateve nga aspektet njerëzore dhe mohimi i dinjitetit universal;
- » Paraqitja e terrorizmit si diçka tërheqëse dhe legjitime;
- » Mbështetja te legjimiteti i perceptuar i terroristëve dhe i udhëheqësve të tyre.

Te deklaratat a shprehjet që mund të thuhen nga një ekstremist i dhunshëm përfshihen:

- » Vdekja dhe shkatërrimi janë e vetmja mënyrë për ta mbrojtur kombin tonë;
- » Nëse vdisni për këtë arsy, do të adhuroheni nga familja juaj dhe do të shpërbleheni në jetën e përtejme;
- » Dhuna dhe terrorizmi janë mënyrat më të mira për të ndryshuar politikën qeveritare;
- » Ne kemi nevojë që ju të bashkoheni me luftën tonë dhe të na ndihmoni të ndërtojmë botën e përkryer për popullin tonë;
- » Ju jeni njëri prej nesh. Ju duhet të bashkoheni me luftën tonë;
- » Qeveritë që dëmtojnë njerëzit tanë, ose që shkelin besimet tona, duhet të shkatërrohen.

CILAT JANË METODAT QË PËRDOREN PËR REKRUTIM?

Rekrutimi është një proces kompleks. Grupet terroriste dhe ekstremiste përpilen në mënyrë aktive që të rekrutojnë anëtarë të rinj për t'u bashkuar me kauzën e tyre.

Ka individë që angazhohen me përgatitjen e një sasie të madhe të materialit propagandues, duke përfshirë edhe atë në internet. Ekstremistët u bëjnë thirrje edhe vajzave të reja. Ata përpilen ta arrijnë këtë me portretizimin e një familjeje të madhe e të lumtur. Një shembull konkret është rasti i fëmijëve, vajza apo djem, familja e të cilëve është divorcuar dhe ndihen të zbrazëti. Ekstremistët propagandojnë sikur e mbushin këtë zbrazëti. Ata përpilen t'i bindin vajzat duke bërë thirrje si: "Bashku me këtë familje të mrekullueshme" dhe "Ne kemi gra nga e gjithë bota, ti do ta adhuroosh këtë vend".

CILAT JANË TAKTIKAT TERRORISTE?

Taktikat terroriste priren të favorizojnë sulme që shmangin marrjen e masave efektive dhe shfrytëzojnë dobësitë. Disa nga taktikat që përdoren më së shumti nga grupet terroriste janë:

- ▶ **Sulme me armë,**
- ▶ **Rrëmbimet/marrja e pengjeve,**
- ▶ **Bombardime dhe sulme vëtëvrasëse/kamikaze.**

Po ashtu, janë bërë të zakonshme edhe sulmet e tipit '**ujk i vëtmuar**'. Ka edhe taktika të tjera më të pazakonta, të cilat janë përdorur në disa raste dhe që përbëjnë kërcënëm serioz.

Të tilla janë bioterrorizmi, agroterrorizmi, terrorizmi bërthamor dhe terrorizmi kibernetik. Terrorizmi kibernetik është një nga kërcënimet me të mëdha.

Vini re! Për terroristët, dokumentet e udhëtimit janë po aq të rëndësishme sa edhe armët.

QASJA E TË DREJTAVE TË NJERIUT KUNDREJT TRAJTIMIT PARANDALUES OSE NDËSHKUES TË INDIVIDËVE TË PËRFSHIRË NË AKTE TERRORISTE.

Tortura dhe trajtime të tjera mizore, degraduese, çnjerëzore apo ndëshkimi janë absolutisht të ndaluara dhe nuk mund të justifikohen në asnjë rrëthanë. Kufizimet e të drejtave të njeriut në luftën kundër terrorizmit, nëse janë të lejuara, duhet të jenë qartazi të përshkruara në ligj, duhet të jenë të nevojshme, të justifikuara, proporcionale dhe jodiskriminuese.

A MUND TË LUAJË ROL SHOQËRIA CIVILE NË PARANDALIMIN E EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM?

Sigurisht që po! Shoqëria civile ka shumë kapacitete. Ajo ka një rol të veçantë aktiv në rritjen e ndërgjegjësimit të komunitetit, duke luftuar stereotipet fetare dhe duke ushtruar një presion pozitiv ndaj aktorëve të ndryshëm, me qëllim krijimin e një shoqërie inkluzive/gjithëpërfsirëse dhe jo ekskluzive/përjashtuese. Shoqëria civile ka fuqi të tregojë mbështetjen e saj kundër këtyre fenomeneve shqetësuese.

CILI ËSHTË ROLI I INSTITUCIONEVE ARSIMORE NË PARANDALIMIN DHE SHMANGIEN E EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM?

"Arsimi është arma më e fuqishme që mund ta përdorni për të ndryshuar botën" - Nelson Mandela

Shkollat kanë rol kyç në formimin e çdo individi. Mënyra se si e përqasin mësuesit, por edhe psikologët ose punonjësit social çështjen e ekstremizmit, është shumë e rëndësishme. Ata duhet të jenë të kualifikuar dhe mirinformuar mbi këto fenomene. Toleranca dhe harmonia kërkojnë devotshmëri në formimin e individit, pra edhe të shoqërisë shqiptare.

Nisma '**Shkolla si qendër komunitare**', nxit partneritetin ndërmjet shkollave, familjeve dhe të gjithë komunitetit. Në këtë mënyrë, shkollat shndërrohen nga institucione që vetëm ofrojnë arsim, në katalizatorë të kohezionit dhe zhvillimit të komunitetit. Kjo nismë ofron një instrument të fortë afatgjatë, ku shkollat luajnë një rol kyç në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm, duke ofruar shërbime këshillimi dhe duke vepruar si hallkë qendrore në konceptimin e programeve parandaluese. Në këtë pikë, një rol të rëndësishëm luajnë fuqizimi dhe trajnimi i mësuesve, edukimi civil fetar, nismat artistike e sportive, klubet e debatit, si dhe veprimtarive që nxisin qëndresën.



KOSTOT E TERRORIZMIT

Kostot e terrorizmit janë afatgjata dhe shumëplanëshe. Ato kanë efekte në ekonomi, shëndet, siguri, frikëra, stres, marrëdhënje, urrejtje, diskriminim, pasiguri, humbje jete, gjymtime, emocione të zymta....

ROLI I MEDIAVE

Mediat luajnë rol kryq në uljen e ndikimit të propagandës së ekstremizmit të dhunshëm dhe rekrutimit në internet. Media sociale dhe jo vetëm duhen shfrytëzuar për hartimin dhe përcimin e mesazheve alternative pozitive.

KUJDES!

Materiali propagandues i grupeve terroriste paraqitet në një shumëlojshmëri platformash të mediave sociale, duke përfshirë Twitter-in dhe Facebook-un, të cilat shpesh janë të lidhura me videot Youtube. Faqet e internetit dhe platformat e mediave sociale përdoren për të shpërndarë propagandën dhe për të nxitur një ndjenjë komuniteti për përkrahësit, veçanërisht kur përpiken të tërheqin të rinxjtë në kauzën e tyre.

BOTIMET TERRORISTE

Përpara se interneti të përhapej në masë të gjerë, terroristët përdornin forma të tjera të medias për të promovuar propagandën e tyre dhe joshur anëtarët. Ka edhe një numër revistash me cilësi të lartë, që duken si profesionale dhe që mund të shkarkohen nga interneti. Këto promovojnë ekstremizmin dhe dhunën, por ofrojnë edhe instrukSIONE se si të bëhet survejimi, si të organizohet sulmi, si të përgatiten bombat etj. Disa nga revistat përbajnjë poezi, të tjera shesin mallra, por që të gjitha kanë për qëllim rekrutimin dhe radikalizimin e dhunshëm.

CILAT JANË ANGAZHIMET E SHQIPËRISË PËR TË PARANDALUAR EKSTREMIZMIN E DHUNSHËM QË ÇON NË RADIKALIZËM TERRORIST?

Shqipëria nuk është drejtpërdrejt e kërcenuar nga aktet terroriste krahasuar me vendet e tjera të Europës, por ekstremizmi si fenomen duhet të konsiderohet si një kërcënim që mbart potencialin e përhapjes në shoqëri.

STRATEGJIA KOMBËTARE PËR LUFTËN KUNDËR EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM, SË BASHKU ME PLANIN E VEPRIMIT [VENDIMI NR. 930/18.11.2015], SYNON:

Nga pikëpamja politike:

- Forcimin e bashkërendimit dhe bashkëpunimit në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar.
- Eliminimin e ndikimit të propagandës negative të ekstremizmit të dhunshëm, si dhe rekrutimit në internet, përmes propagandës dhe mesazheve alternative pozitive të ushtruara nëpërmjet mediave sociale.

Nga pikëpamja juridike:

- Nxitjen dhe garantimin e një mqedisi të sigurt, bazuar në respektimin e të drejtave dhe vlerave themelore demokratike, ku element kyç për sigurimin e paqes dhe stabilitetit në Shqipëri e rajon përbën kultivimi i traditës së bashkëjetesës fetare, bazuar në respektin për të drejtat e njeriut, shtetin e së drejtës, barazisë dhe liritë themelore.

Nga pikëpamja sociale:

- Nxitjen e politikave përfshirëse, me programe aktive të përmirësuara punësimi, të vëna në dispozicion të të rinjve.
- Nxitjen e studimeve dhe kërkimeve për të kuptuar sa e rëndë është gjendja në vend, me qëllim që të evidentohen kushtet, faktorët dhe stimujt që nxisin fenomenin.
- Përforcimin e programeve dhe politikave parandaluese arsimore, të punësimit apo të policimit.

REALITETI PËRMES STATISTIKAVE, I - PËRFSHIRJA E QYTETARËVE SHQIPTARË NË KONFLIKT?

Raportet e para për ekstremistët shqiptarë që udhëtonin drejt Sirisë u përgatitën në vitin 2012. Është interesante të theksohet se përqindja e popullsisë shqiptare që bashkohej me ISIS-in ishte shumë më e lartë krasuar me vendet e tjera më të mëdha evropiane. Raportet sqaronin se numri i ushtarëve shqiptarë që hynin në konflikt ishte rritur vazhdimisht gjatë gjysmës së dytë të vitit 2013 deri në gjysmën e parë të vitit 2014.

Numri i ushtarëve të huaj (me origjinë nga Shqipëria) në Siri dhe Irak llogaritet të jetë përafërsisht 90 deri në 150 individë. Disa shqiptarë janë vrarë gjatë luftimeve. Burimet mediatike sigurojnë se deri në prill të vitit 2015 janë vrarë rrëth 12 shqiptarë. Në anën tjetër, burimet zyrtare deklarojnë se numri i individëve të vrarë në luftë është 18, ndërsa personat e plagosur janë 7. Një numër i konsiderueshëm i individëve që hyjnë në konflikt (rrëth 30) kanë marrë trajnim ushtarak në Shqipëri ose në rajone të tjera.

REALITETI PËRMES STATISTIKAVE, II - ÇFARË MASASH KANË MARRË AUTORITETE SHQIPTARE?

Autoritetet shqiptare kanë arrestuar 15 individë me akuzën e "nxitjes së ekstremizmit dhe terrorizmit", "rekrutimin e individëve me qëllim të kryerjes së akteve terroriste dhe financimit të aktiviteteve terroriste", si dhe "nxitjen e publikut për të kryer akte terroriste". Gjashtë të tjerë janë në kërkim nga policia. Dy persona aktualisht të arrestuar janë vetëdekluarar imamë.



ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE
KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

www.agc.org.al